

bardh për në fshatin Rakoc/Ratkovac, ku pritinin që kushërinjtë e Besnikut t'ju ndihmonin të binin në kontakt me shtabin e atjeshëm të UÇK-së. Rrugës e sipër, kanë kaluar pa pengesë pranë postbllokut policor të fshati Gradish/Gradiš. Në fshatin Malësia e Vogël/Radošte, hasën në një postbllok të UÇK-së. Pjesëtarët e UÇK-së filluan t'i merrnin në pyetje për shkak të dyshimit se ata ishin spiunet serb, pasi që pa probleme e kaluan postbllokun policor në Gradish/Gradiš. Më pas, e çuan Besnikun dhe Muharremin në shtabin e UÇK-së në **Drenoc/Drenovac**. Nëna e Besnikut, Hyrmete, ka mësuar nga djemtë e motrës se Besniku gjendej në Drenoc/Drenovac, dhe se kishte porositur që ajo t'i dërgonte disa gjësende. E ka vizituar dy herë, herën e fundit më **14.07.1998**. Me të ishin edhe dy vajzat e Besnikut. E kanë gjetur atë në godinën e shkollës. Biseduan me të, i dhanë disa rroba dhe ca gjësende të tjera të imta. Më vonë, Hyrmetja ka dëgjuar nga Muharremi se ai kishte qëndruar tri javë rresht me Besnikun në Drenoc/Drenovac, dhe se Besniku mbeti atje pasi Muharremi u lirua. Në muajin dhjetor të vitit 2006, Zyra e UNMIK-ut për Persona të Zhdukur i ka njoftuar familjarët se ishin identifikuar mbetjet mortore të Besnikut, të cilat u zhvarrosën nga varrezat e Pejës/Peć. Familjarët refuzojnë t'i marrin mbetjet mortore të Besnikut, përderisa atij nuk i njihet statusi i dëshmorit të luftës.

Burimet: deklarata M.K, FDH-20600; deklarata H.K, FDH-2569.

Velika (Trajko) Petrović

(1943, srbe nga Zoqishta/Zočište, komuna e Rahovecit/Orahovac, amvise, gjashtë fëmijë)

Velika ka lindur në Bratotin. U martua për Dušanin në vitin 1964. I ka lindur katër vajza dhe dy djem. Në muajin korrik të vitit 1998, burrat e **Zoqishtës/Zočište** kanë filluar të organizonin rojën pranë hyrjeve në fshat. Herët në mëngjes, në datën **17.07.1998**, rreth orës 4:00 të mëngjesit, Velika doli prej shtëpisë dhe u nis drejt tualetit fushor. Dušani, i cili në bodrumin e shtëpisë me kumbarën e tij e mbanin rojën, i dëgjoi hapat e saj dhe mendoi se dikush po

tentonte të afrohej fshehurazi. Ka shtënë nga pushka e tij e gjetisë drejt zhurmës që vinte nga jashtë dhe padashur e vrau Veliken. E varrosën në oborr. Familjarët e braktisën fshatin shumë shpejt pas kësaj ngjarjeje. Kur, pas pesë javësh, u kthyen në fshat, e gjetën varrin e saj të hapur. Atëherë, familjarët e rivarrosën kufomën e Velikes në varrezat lokale.

Burimet: deklarata D.P, FDH-33902; deklarata B.M, FDH-20096; *Oteta çtrdesetdvoje ljudi*, Oteta istina, num. 19, korrik - shtator 2009, 15, FDH-30424.

Mark (Palush) Gashi

(28.01.1927, shqiptar nga fshati Dobërdoll/Dobri Dol, komuna e Rahovecit/Orahovac, pensionist, gjashtë fëmijë)

Marku deri në vitin 1995 punonte si rojtar i vreshtave të fabrikës së venës në Rahovec/Orahovac. Ishte anëtar i Partisë Socialiste të Serbisë. Në fshat situata ishte përkeqësuar, pas konflikteve të UÇK-së dhe policisë serbe që u zhvilluan afër postbllokut policor në fshatin Kramovik, më 14.07.1998, kur edhe u paraqit UÇK-ja në këtë fshat.

Në datën **17. 07. 1998**, rreth orës 15:00, në oborrin e Markut [**Dobërdoll/Dobri Dol**] kanë hyrë katër meshkuj të maskuar me uniforma ngjyrë të gjelbër. Ata flisnin shqip. E thirrën Markun, ai doli nga shtëpia dhe pas bisedës që patën, u kthye në shtëpi, i mbathi këpucët dhe familjarëve u tha se do të kthehet shumë shpejtë. Nuk u kthye kurrë më. Trupi i një maskulli të panjohur është gjetur në rrugën Mitrovicë/Kosovska Mitrovica – Skënderaj/Srbica, në një ngastër të fshatit Braboniq/Brabonjić, afër stacionit të autobusëve. Pas hetimit të kryer nga policia serbe u konstatua se bëhej fjalë për Mark Gashin.

Burimet: deklarata K.G, FDH-30782; deklarata M.C, FDH-5699; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, V, 360; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, II, 758; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; KKMKRF, *Personal...*, FDH-10832; FDH, *Registri...*, FDH-5515; SMIP, *Teroristički...*, III, 82; *Teroristi mučili i ubili 67 nedužnih civila*, Politika, 14.09.1998, <http://www.arhiva.srbija.sr.gov.yu/vesti/1998-09/17/5250.html>.